



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E MJEDISIT PYJEVE DHEADMINISTRIMIT TE UJRAVE**  
**AGJENSIA E BASENIT MAT**

---

**V e n d i m**  
**Nr. 4/Date 14.07.2006**

**“Per**  
**Krijimin e grupit te punes mbi verifikimin e subjekteve qe perdorin**  
**ujin pa leje perdorimi”**

Ne mbeshteje te ligjit nr.8093 dt. 21.03.1996 “Per rezervat ujore”, te neneve 6,12,18...  
Vendimit te K.K.Ujit Nr. 289 dt.15.04.2005 “Per percaktimin e kerkesave dhe  
procedurave per miratimin e lejeve, te autorizimeve dhe te koncesioneve per perdorimin  
e ujit”, Keshilli I Basenit Mat;

**V e n d o s i :**

1. Te ngrihet grupi i punes per evidentimin e subjekteve, personave fizik dhe privat familjar qe perdorin ujin ne menyre te paligjshme per cdo komune e bashki Brenda pellgut basenit Mat.
2. Grupi i punes te ndertohet me nengrupe pune per cdo njesi vendore te cilat kryesohen nga kryetaret e komunave dhe bashkive Brenda ketij baseni.
3. Grupi i punes drejtohet teknikisht nga A.U.B.-ja e cila njekohesisht kordinon punen edhe me A.R.M. dhe Drejtorite e Ujsjelles Kanalizimeve per liqensimin e subjekteve qe perdorin ujin.
4. Bashkite, Komunat, Drejtorite e Ujsjellsave dhe A.R.M.-te duhet te respektojne afatet e percaktuara nga A.U.B. per plotesimin e te dhenave qe kerkohen nga kjo agjensi ne lidhje me perdoruesit me leje dhe pa leje te ujit.
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**K.B.U. Mat**  
**SEKRETARI**  
**Pashk NDOCI**

**K.B.U. Mat**  
**KRYETARI**  
**Njazi REÇI**

